

# ASAJ

N. 1

*Botëkuptimi i asaj  
mbi të bukurën!*

*në çdo detaj*

**Mars 2026**

## PORTRET

**Në sytë e asaj**

Arjana Fetahu Gaba

## STIL

**Asaj që guxon**

Çfarë të veshësh në Mars

## MENDJE

Si lindi buzëkuqi, perlat  
dhe këpucët a asaj

## FRYMË

**T'i shkruash asaj**

Si ta bësh për vete atë

## ASHTU

Prapaskenat e "Asaj"



## Mirëseardhja e Bordit Editorial

*Bukuria si "Gjendje Shpirtërore", jo si formë*

### **E dashur Grua,**

*"Kush e përcakton, atë që ne shohim në pasqyrë?*

*Për shumë kohë, ne i kemi dorëzuar 'çelësat' e vetëperceptimit tonë standardeve të huaja, trendeve kalimtare dhe pritshmërive që nuk na përkasin.*

*"Asaj", revista më e re online beson se autoriteti i vetëm mbi pasqyrimin tonë duhet të jetë vetëdija jonë.*

*Ajo që shohim nuk është thjesht një imazh, por një gërshetim i betejave që kemi fituar, i buzëqeshjeve që kemi dhuruar dhe i asaj drite të brendshme që asnjë tualet nuk mund ta imitojë.*

*Në një botë që shpesh përpiqet ta përkufizojë të bukurën përmes përmasave dhe filtrave, "Asaj" vjen si një ftesë për të ndaluar dhe për të parë përtej sipërfaqes.*

*Në faqet e kësaj reviste, ne refuzojmë të jemi vëzhguese pasive të bukurisë sonë; ne zgjedhim të jemi arkitektet e saj, duke i dhënë pasqyrës kuptimin që ne meritojmë.*

*Këtu, bukuria nuk kërkon leje; ajo manifestohet në guximin për të qenë autentike, në hirin e papërsosmërisë dhe në atë forcë të qetë që vetëm "Asaj" di ta mbartë.*

*Ky numër i parë nuk është thjesht një fillim i ri, por një manifest i botëkuptimit tonë: se e bukura nuk është një destinacion që arrihet, por një lente përmes së cilës zgjedhim të shohim veten dhe botën.*

*Në këtë numër të parë, ne kemi planifikuar një udhëtim që prek çdo dimension të botëkuptimit tonë.*

*Do të gjeni intervista me gra që kanë guxuar të sfidojnë 'perfekten', ose që eksplorojnë lidhjen mes stilit personal dhe lirisë shpirtërore, si dhe këshilla që nuk synojnë të na ndryshojnë, por të na rafinojnë.*

*Ky nuk është thjesht një koleksion artikujsh, por një hapësirë ku arti, mirëqenia dhe estetika bashkohen për të kremtuar gruan në të gjithë kompleksitetin e saj.*

*Ju ftojmë të shfletoni këto faqe jo si dikush që kërkon të përmirësohet, por si dikush që kërkon të njihet me fuqinë e saj të vërtetë.*

*Pikërisht për të kuptuar këtë ndjesi të hollë të së bukurës, në rubrikën tonë qendrore "Në sytë e asaj" kemi kënaqësinë të bisedojmë me poeten Arjana Fetahu Gaba.*

*Përmes vargjeve dhe reflektimit të saj, Arjana tregon se si poezia nuk është thjesht art në letër, por një formë jetese.*

*Ajo na rrëfen se ku e gjen muzën e saj dhe se si shpirti i një gruaje arrin ta përkthejë botën në një përjetim estetik e shpirtëror.*

*Ky numër i parë i 'Asaj' nis kështu: me poezi, me vërtetësi dhe me dëshirën për të parë botën përmes një lenteje më njerëzore.*

*Mirë se vini në udhëtimin tonë të parë!*

**Përzemërsisht,  
Bordi Editorial**



### **Rubrika jote: Ashtu si jam!**

*Kjo do të jetë rubrika jonë e preferuar, sepse Historia jote është muza jonë!*

Titulli emocional dhe intim bën që "Ashtu si jam" të jetë vendi ku nuk ka gjykime, ku Ti mund të zhvishesh nga rolet e përditshme (nënë, bashkëshorte, grua) dhe të tregosh veten tënde të vërtetë.

**Mesazhi:** "Unë jam e mjaftueshme, me të gjitha dritëhijet e mia."

Revista: **Asaj** (Për atë)

Rubrika: **Ashtu si jam** (Për mua)

Na shkruaj historinë tënde, pyetjet, rrëfimet, nevojat, apo ndihmën që të duhet në:

**revista.asaj@gmail.com**

**për të qenë E Përzgjedhura e Muajit  
dhe fituese e një çmimi surprizë**

# Arjana

Revista jonë titullohet thjesht **"Asaj"** – një dedikim për gruan, vëzhgimin dhe botëkuptimin e saj. Si poete, në vargjet tuaja, në ndjejmë shpesh se **"Ajo"** nuk është thjesht një personazh, por një gjendje shpirtërore. Për ju, kush është **"Ajo"** që shkruan, që ndjen dhe që gjen të bukurën edhe aty ku bota harron të shohë?

Arjana: Gruaja në mua, pa diskutim!

Arjana, ju jeni një poete e afirmuar, e talentuar, me një penë të veçantë dhe katër libra të suksesshëm të botuar. Lexueset e **"Asaj"** kanë dëshirë të të njohin ty, ndryshe, ashtu si nuk je prezantuar më parë...

Arjana: (qesh...) Unë jam gati për çdo pyetje.

Le të kthehemi shumë vite pas në rininë tënde. Ju keni pothuajse 30 vite jetë së bashku me bashkëshortin tuaj, Albanian. Pas sa kohësh që bashkëshorti yt "të kërkonte me sy" mes mijëra vajzave, ti arrite ta kuptosh?

Arjana: Kjo është një pyetje që prek atë komunikimin "pa fjalë" që ndodh shpesh në fillimet e një romance ose brenda një martese. Koha që i duhet dikujt për të kuptuar se po **"kërkohej me sy"** ndryshon shumë dhe varet nga marrëdhënia, rrethanat, etj. Mbjaj mend se **"kërkimi me sy"** ndodhi nga të dy njëkohësisht. Si të thuash, kishim një tërheqje apo një magji në të njëjtën kohë... Ndoshta ato shikime do t'i referoja si **"dashuri me shikim të parë"**.

Kush e bëri hapin i pari dhe si?

Arjana: Hapin e parë në historinë tonë e bëri Albani, ndonëse në fillim gjithçka nisi si një kërkim i heshtur që vetëm ai e dinte. Ai më kishte parë rastësisht në restorantin ku punoja dhe, ndonëse unë nuk e kisha vënë re fare, atij i kisha mbetur aq shumë në mendje sa vendosi të kthehej përsëri vetëm për të më takuar. Por fati deshi që në atë moment rrugët tona të dukeshin të pamundura; unë isha larguar edhe nga puna, edhe nga qyteti, duke e lënë atë të trishtuar dhe pa asnjë gjurmë timen...

**Megjithatë, ajo që është e shkruar nuk humbet kurrë!**

Pas dy-tre muajsh, ndodhi mrekullia e vërtetë e rastësisë!

Kushëririn im erdhi të më takonte për një porosi dhe, krejt papritur, ai erdhi me një shok, i cili e imagjinon dot kush ishte?! Ishte Albani... **(qesh dhe bukuria i lexohet në fytyrë)** Sa e mundur është që të ndodhi kjo? Më thuaj!

Ajo që na la pa mend ishte fakti se unë isha zhvendosur në fakt në qytetin ku jetonte Albani, dhe ... prit se nuk ka mbaruar, shtëpia ime ishte dy rrugë larg shtëpisë së tij...

Dmth, Nga dy skaje të largëta, jeta na kishte sjellë më afër se asnjëherë. Një mesazh që dëshiroj t'i jap lexueseve të **"Asaj"** është se: **Kur e mendon se jeni humbur, në fakt sapo jeni gjetur...**

Ajo që e mbaj mend edhe sot nga ajo ditë e para 30 viteve është buzëqeshja me shpirt e Albanit kur më ka parë atë takim...

Ishte një moment magjik ku kuptuam se, pavarësisht lëvizjeve tona, fati kishte thurur një plan shumë më të bukur se sa edhe vet ne për të qenë kaq afër njëri-tjetrit.

**Poezia nuk shkruhet, ajo jetohet...**



A ka ndonjë histori të shkurtër të veçantë që e mban mend kur të dy e kuptuat/vendosët që ishit fati i njëri-tjetrit?

Arjana: Në fakt, nuk ishte një datë e shënuar apo një dhuratë e madhe, por ishte vetë **ajo ndjesia e bukur e "shtëpisë" që gjetëm te njëri-tjetri** pas asaj rastësie të çmendur. Mbjaj mend që, pas atij takimi të rastësishëm filluam të kalonim çdo moment bashkë.

Aty kuptuam se **universi e kishte një plan për ne...** ishte një forcë më e madhe që na kishte sjellë nga dy skaje të kundërta për të na bërë një. Kur uleshim dhe bisedonim për atë kohën kur ai më kërkonte në restorant dhe unë isha "zhdukur", e shihnim njëri-tjetrin në sy dhe **e ndjenim se ajo nuk ishte thjesht një koinçidencë**. Ishte ai momenti i qetësisë, ku e kuptuam se nuk kishim më nevojë të kërkonim diku tjetër, sepse gjithçka që na duhej ishte vetëm pak hapa larg. Aty e vendosëm, pa pasur nevojë për shumë fjalë, se ky ishte fati ynë i shkruar dhe se rrugët tona nuk do të ndaheshin më.

Nga 1 në 10 ku do ta vlerësoje "çmendurinë" që Albani ka bërë ndonjëherë pas teje? Dhe, çfarë ka bërë?

Arjana: Nëse do të më duhej ta vlerësoja, pa dyshim që do t'i jepja 11 (... qesh)

Dhe këtë nuk e them thjesht për historinë tonë të fillimit, por sepse Albani **gjen gjithmonë mënyra "të çmendura"** që më lënë pa fjalë.

Një nga rastet që më ka surprizuar por edhe lumturuar me "çmenduritë" e tij ishte një rast kur fluturova nga New Jersey për në St. Louis për të kaluar disa ditë me prindërit e mi. Në të njëjtën kohë Albani kishte një udhëtim për në Shqipëri, mirëpo, krejt papritur **Albani "nuk po e gjente dot" pasaportën** e tij amerikane.

Në vend që të zgjidhte rrugën më të thjeshtë e më logjike - të shkonte vetëm dy orë larg në Philadelphia, të paguante një tarifë extra të merrte pasaportën e re brenda ditës - **ai bëri të pamendueshmen**: bleu dy bileta avioni për mua nga Missouri në New Jersey dhe anasjelltas, vetëm që **"unë ta ndihmoja të gjente pasaportën"**... E kuptova menjëherë që pasaporta ishte thjesht një pretekst i bukur... Malli i tij për mua ishte gati **të vinte në lëvizje avionët** vetëm që të më shihte edhe një herë para se të nisej për në Shqipëri. Kjo lloj "çmendurie" e tij, ku malli fiton mbi çdo logjikë, më bën të qesh e të ndihem e plotë sa herë e kujtoj.

## PORTRET

Në sytë e Asaj

Arjana Fetahu Gaba

...vijon intervista nga faqja parardhëse

# Arjana dhe sfida me kancerin

Ju keni vetëm 3 djemë. Ti je "Nëna Mbretëreshë" e djemve të tu. A ndihet mungesa e "Princeshës së babit" në familje?

Arjana: Të jesh "Mbretëresha" në një shtëpi me katër burra është një bekim i madh, por do të gënjeja po të thoja se ideja e një "Princeshe" nuk na ka kaluar nëpër mend. Sidomos për Albanin, i cili si çdo baba, besoj se e ka pasur atë ëndrrën e fshehur për një vajzë të vogël që do **t'i zbuste zemrën me një shikim**. Edhe për mua, një vajzë do të ishte ajo shoqja e ngushtë për bisedat "goça me gocë" dhe për të ndarë ato sekretet e vogla që vetëm ne i kuptojmë.

Aq shumë e kemi dashur sa **edhe emrin ia kishim gjetur** (... qesh). Për mua, "**Ajo**" do të ishte Dea ndërsa për Albanin, Teuta si Mbretëresha e Durrësit.

Ndonëse ajo figurë mbetet si një dëshirë e ëmbël e paplotësuar, jeta na fali tre djem që janë pasuria jonë më e madhe. Ata kujdesen çdo ditë që unë të mos e ndjej **mungesën e dashurisë apo vëmendjes**, duke më bërë të ndihem vërtet e vetmja "Mbretëreshë" në botën e tyre. Është një ekuilibër i bukur ku, edhe pse mungon një princeshë, shtëpia jonë është plot me dritë nga tre djemtë tanë.

**E falenderoj Albanin dhe familjarët që ishin shtylla ime kur bota po më dridhej.**

**Ai nuk është thjesht bashkëshorti im!**

**Ai është prova se, dashuria e shkruar në yje e gjen gjithmonë rrugën për në shtëpi...**

Kush ka qenë sfida më e madhe në jetën tuaj bashkëshortore?

Arjana: Sfidat më të mëdha dhe më të fortë ishin padyshim momenti kur **u diagnostikova me kancer gjiri**.

Ishte një rrugëtim i gjatë, i mundimshëm e plot pasiguri, që na **tronditi të dyve deri në palcë**. Në ato ditë të vështira, nuk ishte vetëm trupi im që luftonte, por ishte e gjithë familja jonë që qëndronte në këmbë me shpresë. **Albani ishte shtylla ime**; ai nuk më la asnjë sekondë të dorëzohesha, duke dëshmuar se dashuria jonë ishte më e fortë se çdo sëmundje.

Ajo periudhë na mësoi **vlerën e vërtetë të jetës** dhe na lidhi akoma më fort me njëri-tjetrin, duke na treguar se kur jemi bashkë, asnjë mal nuk është i pakapërcyeshëm.

Si e zbuluat? Çfarë ndodhi?

Gjithçka nisi rastësisht nga **një kontroll rutinë**. Dyshimet e doktorit, shtimi i numrit të analizave dhe, në fund, **biopsia** sollën **diagnozën e sakte: Kancer gjiri**. Na ra qielli mbi kokë! Kur e kujtoj sot atë ditë kuptoj se Zoti ndonjëherë na i jep shenjat vogla. Nëse unë nuk do të kisha shkuar te mjeku në **kontrollin rutinë, në dukje të parëndësishme**, ndoshta nuk do ta kisha marrë vesh kurrë aq herët diagnozën time. Fakti që e kapëm në kohë **ishte bekim dhe dorë e Zotit mbi ne**. Jam mirënjohëse çdo ditë që ai kontroll "i thjeshtë" u bë **rruga ime drejt shërimit dhe jetës**, duke më dhënë mundësinë të jem ende këtu pranë njerëzve të mi të shtrenjtë.

## STIL

Asaj që guxon

Çfarë të veshësh në Mars

Mars 2026

Trendet e modës anojnë drejt një përzierjeje nuancash të guximshme e të gjalla dhe tonesh të thella të sofistikuara, duke u larguar nga pastelet e thjeshta.



PANTONE Muskmelon 2026	PANTONE Burnt Sienna 2026	PANTONE Dusty Rose 2026	PANTONE Amaranth 2026
------------------------------	---------------------------------	-------------------------------	-----------------------------

**E gjallë dhe e guximshme:** E kuqe domate, blu kobalti, çiklaminë, e verdhë me diell dhe nuanca të theksuar.

**E thellë dhe me humor:** Jeshile smeraldi, vjollcë mbretërore dhe blu e thellë.

**Neutrale të sofistikuara:** E bardhë "re-dancer", ngjyrë karameli dhe espresso.

**Tone më të buta:** Rozë karameli, blu e kaltër dhe blu akulli.

**Këshillë: Marsi mund të jetë ende i ftohtë, prandaj merrni në konsideratë një pallto të ngrohtë në ngjyrë neutrale si Bezhë, Karamel, apo Rozë e lehtë për ta vendosur sipër këtyre nuancave të reja të gjalla.**



Ngjyrat kryesore për t'u veshur përfshijnë të kuqen e ndezur si domate, blunë kobalt, të verdhën me diell, çiklaminën e gjallë, jeshilen e pasur smerald ose të myshkut. "Cloud Dancer" (një e bardhë e butë) është një nuancë neutrale në pjesën e sipërme, së bashku me ngjyrën karamel.

# JETË

## Pranvera kërkon shtëpi të re... Çfarë na duhet ta ri-dizenjojmë?

### Ja si mund ta fillosh këtë udhëtim hap pas hapi

Përmendja e ri-dizajnit të shtëpisë është hapi i parë drejt një hapësire që reflekton vërtet energjinë dhe nevojat e tua. Për një grua që kërkon të transformojë ambientin e saj, procesi nuk është thjesht të ndërrojë mobiliet, por për krijimin e një "strehe" që ushqen mirëqenien.

Krijoni një "Moodboard" (Tabela e Ideve)


Nuk ka nevojë të jesh arkitekte për të vizualizuar. Përdor platforma vizuale për të mbledhur imazhe që të pëlqejnë: Google - Krijoni tabelë të ndryshme për çdo dhomë. Instagram - Ruaj postime nga dizajnerë që të frymëzojnë. Facebook - Shkarko foto të ndryshme gjatë postimeve të të tjerëve. Fillo të krijosh pamjen në kokën tënde: mobiliet, ngjyrat dhe materialet në një faqe të vetme për të parë nëse shkojnë bashkë.

Përcakto "Ndjenjën", jo vetëm Stilin

Përpara se të shfletosh katalogët, pyet veten: Si dua të ndihem kur hyj në këtë dhomë? Për Qetësi: Fokusohu te ngjyrat neutrale dhe materialet natyrale (dru, lino). Për Produktivitet: Kërko ndriçim të fortë dhe linja të pastra. Për Ngrohtësi: Shto tekstura si kadifeja, tapetat e trashë dhe ndriçimin e ngrohtë.

Analizo funksionalitetin (Rituali yt ditor)

Dizajni i mirë zgjidh probleme. Shiko si lëviz nëpër shtëpi. Ku grumbullohet rrëmuja? (Ndoshta të duhet një sistem më i mirë organizimi në hyrje). A ka dritë mjaftueshëm për të lexuar apo për t'u grimuar? A është kuzhina praktike për mënyrën si gatuan?



Fillo me "Fitoret e Vogla"

Ri-dizajni nuk do të thotë gjithmonë prishje muresh. Mund të fillosh me lyerjen e një muri. Ngjyra ndryshon totalisht psikologjinë e dhomës. Ndriçimi: Ndërro abazhurët e vjetër me diçka moderne. Tekstilet: Jastëkë të rinj, perde ose një tapet mund ta bëjnë dhomën të duket si e re pa shpenzuar shumë.

## FRYMË T'i shkruash Asaj

## Si ta bësh për vete atë

## Vajzën elegante dhe me klas

Të afroresh me një grua të bukur, elegante dhe me klas, në dukje, e ftohtë ose e distancuar kërkon një ekuilibër midis vetëbesimit, respektit dhe angazhimit pa presion. Çelësi është ta trajtosh atë si një person interesant dhe jo si një çmim, duke u përqendruar te autenticiteti, humori i lehtë dhe krijimi i një hapësire të rehatshme dhe të sigurt për bashkëveprim.

Për të arritur një grua që është "e ftohtë", duhet të largohesh nga pamja e saj dhe të drejtohesh nga mendja dhe kufijtë e saj.

3. **Pasqyro ritmin e saj:**  
Nëse ajo është e shkurtër në pëgjigje, ji edhe ti i shkurtër. Përputhja me energjinë e saj "të ftohtë" tregon se nuk je i dëshpëruar, gjë që shpesh është gjëja më tërheqëse për dikë që është i mbrojtur.

1. **Hiq dorë nga lajkat:**  
Ajo është mësuar t'i thuhet se është e bukur. Komplimentimi për pamjen e saj të bën "thjesht një djalë tjetër". Në vend të kësaj, përmend një detaj jo-fizik ose një shije specifike që ajo ka.

2. **Nise bisedën pa presion:**  
Përdor strategjinë "Unë po dërgoj një mesazh por nuk do të pres për një përgjigje"...  
Bëj një pyetje të shpejtë ose bëj një vëzhgim që nuk kërkon një përgjigje të gjatë. Kjo e ul vigjilencën e saj sepse nuk i kërkon kohë të përqendrohet.

4. **Bëhu Përjashtimi:**  
Shumica e burrave të tjerë përpiqen ta "shkrijnë" atë me nxehtësi. Ti ji ndryshe! Bëhu djali që është i qetë, që ka angazhime, dhe është i zënë me jetën e tij.



# MENDJE

## Buzëkuqi, Perlat dhe Këpucët për një Zonjë Elegante

Buzëkuqi nuk u "shpik" nga një person i vetëm në laborator, por evoluoi gjatë 5,000 viteve. Në fillim, burrat dhe gratë e lashtë vendosnin gurë të çmuar të grimcuar në buzë, ndërkohë që Egjiptianët e vjetër grimcuan insekte dhe i vendosën në buzë. Jemi me fat që sot kemi disa tuba "magjike" rrotullues të cilët nxjerrin të gjitha ngjyrat e buzëkuqëve që duam.

### Inovacione Moderne

**Formula me qëndrueshmëri të gjatë (1950):** Kimistja organike Hazel Bishop zhvilloi buzëkuqin e parë "Pa gjurmë", i cili u bë një sukses i madh komercial.

**Teksturat Mate (1984):** MAC Cosmetics lançoi formulat e para të njohura mat, duke zhvendosur trendet larg përfundimeve tradicionale me shkëlqim ose kremoze.



Shputa (shualli) e kuqe ikonike e këpucës Christian Louboutin lindi nga një "aksident i lumtur" në vitin 1992.

Ndërsa po finalizonte një prototip për këpucën "Pensée" - një dizajn i frymëzuar nga "Flowers" e Andy Warhol, Louboutin ndjeu se shputa e zezë ishte shumë e zbehtë dhe i mungonte energjia e skicës së tij origjinale.

**Simbolizmi:** Louboutin zgjodhi të kuqen sepse është "tërheqëse, flirtuese, e paharrueshme dhe ngjyra e pasionit".

Ai i sheh shputat si një "mjet komunikimi" që fuqizon gratë dhe ofron një "kënaqësi të fshehtë" për atë që i vesh.

**Fillimet e Lashta (3500 p.e.s. – 1000 e.s.)**  
Format më të hershme të ngjyrës së buzëve ishin shenja të statusit dhe fuqisë dhe jo vetëm bukurisë.

**Sumerianët (rreth vitit 3500 p.e.s.):** Mbretëresha Puabi e Urit njihet si përdoruese e parë e regjistruar, duke aplikuar një pastë me gurë të kuq të grimcuar dhe plumb të bardhë.

**Egjipti i Lashtë:** Elitat përdornin okër të kuq të përzier me rrëshirë. Kleopatra mbante një ngjyrë të kuqe të errët të bërë nga brumbuj dhe milingona të kuqe të grimcuara.

**Epoka e Artë Islamike (rreth vitit 1000 e.s.):** Kozmetologu Abu al-Qasim al-Zahrawi shpiku buzëkuqin e parë të ngurtë dhe të parfumuar duke shtypur përbërësit në kallëpe të veçanta.

**Buzëkuqi Parë Komercial (1884):** Shtëpia franceze Guerlain prodhoi buzëkuqin e parë komercial të bërë nga dhjami i drerit, vaji i ricinit dhe dylli i bletës, të mbështjellë me letër mëndafshi.

**Tubi Metalik (1915):** Maurice Levy shpiku tubin e parë metalik "shtytës", duke e bërë buzëkuqin portativ dhe duke e penguar atë të njolloste çantat.

**Tubi Rrotullues (1923):** James Bruce Mason Jr. patentoi mekanizmin rrotullues që përdoret ende në buzëkuqët modernë Chanel ose Maybelline.



### Revolucioni Komercial (1884 – 1923)

Për shekuj me radhë, buzëkuqi përgatitej kryesisht në shtëpi ose shitej në vazo të vogla.

Perlat janë unike si i vetmi gur i çmuar i krijuar nga një krijesë e gjallë, me një histori që shtrihet mijëra vjeçare, fillimisht si thesare të rralla natyrore dhe më vonë si gurë të çmuar të kultivuar. Perlat natyrore janë mbledhur për më shumë se 8,000 vjet, ndërsa perlat e para të suksesshme komerciale të kultivuara u shpikën në fillim të viteve 1900.

**Shekulli i 13-të:** Kinezët eksperimentuan me prodhimin e "perlave me flluska" (që formoheshin brenda guaskës) të mbuluara me baltë në midhjet e ujërave të ëmbla.

**1907:** Tatsuhei Mise mori një patentë për një gjilpërë të veçantë shartimi, thelbësore për procesin modern të kultivimit.

**1917:** Cartier bleu dyqanin e vet kryesor në Fifth Avenue në Nju Jork duke shkëmbyer një gjerdan me perla natyrore me dy fije me vlerë 1 milion dollarë.

**Vitet 1970:** Kina filloi të prodhonte perla të kultivuara të ujërave të ëmbla në treg masiv.

**Sot, mbi 99% e perlave në treg janë të kultivuara.**



**Frymëzimi:** Duke parë asistenten e tij, Sarah, tek po lyente thonjtë e saj me një të kuqe të ndezur, Louboutin mori shishen dhe lyeu të gjithë shputën e këpucës.

### Ndikimi i Menjëhershëm:

Shputa e kuqe "shpërtheu menjëherë", duke i dhënë jetë dizajnit. Louboutin fillimisht kishte ndërmend të ndryshonte ngjyrën e shputës çdo stinë, por pasi pa reagimin e publikut, vendosi ta bënte shputën e kuqe nënshkrimin e tij të përhershëm.

# ASHTU

## Prapaskenat

### Bisedat mes shoqesh mund të krijojnë një Revistë

**Ura e komunikimit:** Kafeja funksionon si një "gjuhë universale" që thyen barrierat midis shoqeve.

Ftesa "dalim për një kafe" përkthehet si momenti i relaksit me miken e ngushtë por edhe si një mjet i rrezikshëm se nga një kafe mund të prodhohet një REVISTE.

Lëre pastaj kur kafeja pihet me pamjen e Manhattan...

Një Dashuri Frymëzimi ❤️

## A e dinit se



Kafeja luan një rol qendror në marrëdhëniet tona shoqërore dhe miqësore duke shërbyer jo vetëm si një pije energjike, por si një katalizator i fuqishëm social që nxit ndërveprimin dhe produktivitetin.

## Si nisi?

Pikërisht në një nga këto kafet, duke parë dëborën e Shkurtit të binte, menduam sa mirë do të kishte qenë të kishim edhe një Revistë në duar, për të lexuar çdo gjë të bukur që i përkiste një vajze. Duke e diskutuar këtë detaj vërejtëm se fjala që përdorëm më tepër gjatë shprehjes së dëshirave tona për një Revistë ishte fjala "Asaj". U pamë në sy dhe e kuptuam menjëherë se kishim gjetur emrin e Revistës dedikuar çdo vajze dhe gruaje shqiptare.

Diskutuam gjatë. Pyesnim veten dhe njëra tjetrën a do të funksiononte... U larguam atë pasdite të ftohtë Shkurti nga kafja por në mesazhet që shkëmbeuam gjatë ditëve apo edhe në bisedat e gjata telefonike, pa kuptuar përfundim duke folur vetëm për "Asaj"...

Dëshira e përbashkët për të krijuar një platformë ku vajzat dhe zonjat të ndajnë zërat, idetë dhe frikërat pa u gjykuar na motivoi të mos ndaleshim deri kur kopertina e revistës kishte mbetur e fundit.

A njohim gra shqiptare që jetojnë dhe punojnë në Amerikë që janë të suksesshme? Padiskutim që po! Dhe jemi kaq krenare që Vajzat dhe Zonjat shqiptare janë një zë i fuqishëm atje! A mund të ishte njëra prej tyre "Fytyra" e bukur dhe motivuese e Revistës "Asaj"? Në mënyrë absolute po! Por, ajo që dëshironim të përcillnim me "Personazhin e Panjohur" në kopertinën e numrit të parë ishte që çdo Vajzë të gjejë veten aty. Po, po! Ki guxim dhe imagjinoje veten tënde të jetë në kopertinën e "Asaj" një ditë. "Asaj" është krijuar për ty! Çdo vajzë fsheh një talent, një dritë, një mirësi dhe vetëm njerëzit e duhur ta nxjerrin të Bukurën jashtë.



Ne e krijuam "Asaj" me iniciativë dhe entuziazëm sepse edhe ne jemi "Ato". Punuam fort dhe e disenuam "Asaj" si një vogëlushe e cila çdo muaj do të rritet, bashkë me Ju. Dashuria dhe energjia juaj do të na ndihmojë të kuptojmë nëse kjo iniciativë ia vlen. Ne të gjitha së bashku, mundemi!

**Vendosëm që "Asaj" ta ketë siparin e vet në muajin Mars sepse Marsi Shqiptar është GRUA!**

**7 Marsi - Mësuesja e Parë e gjuhës Shqipe**

**8 Marsi - Dita Ndërkombëtare e Gruas**

**14 Marsi - Dita e Bukur e Verës**


**21 Marsi - Dita e Parë e Pranverës**

Në jetë një vajzë ka nevojë për një shoqe me të cilën të qeshi; një me të cilën të jetë vetvetja; dhe, një me të cilën ndan qëllimet për jetën dhe aventurat e saj. Je me fat nëse të treja këto i gjen te një shoqe e vetme.



**Gëzoni dhe Festoni me Marsin e Pranverës**

**Çdo vajzë është një Lule që meriton të vlerësohet**



## BIZNESE SHQIPTARE

“Arratisja jote e shijshme”

# Aurora

Mediterranean  
& Seafood  
Restaurant

Një gotë verë e bardhë, aroma e peshkut të freskët dhe shoqëria juaj e preferuar. Ky është momenti juaj i pushimit.



Përdor kodin “ASAJ” për pijen tuaj të preferuar gjatë vizitës suaj të parë

Add. 203 Old Tappan Rd. Old Tappan, NJ 07675

## BIZNESE SHQIPTARE



“Nuk po kërkon thjesht mure, po kërkon një ambient për familjen/veten. Si agjente e dedikuar, unë ju ndihmoj të gjeni pronën perfekte me profesionalizëm dhe besim” -  
**Fanika Janko**

FJanko@yahoo.com

IG: alexnika\_20112

Fcb: Fanika Janko, Realtor

**Real Estate Agent – Tampa Bay Area, FL**

**FLIPPING** - Në bashkëpunim me “Homestar Investment Group” blihen shtëpi të pabanuara, rikonstruktohen sipas ligjit, duke përmirësuar komunitetin dhe rritjen e vlerës së pronave

Shitje - blerje pronash  
Property Management  
Apartamente me qira  
Flipping / Konsulencë e personalizuar për investime në pasuri të paluajtshme

Kërkon një set fotografik që flet? Apo, dëshironi të transformoni momentet tuaja në art? Në të dyja rastet, ju ndihmon një nga zërat më premtues të fotografisë me mjeshtëri implementon vizione të reja në çdo shkrepje...  
**Vasjana Minga**


vasjana01@gmail.com

IG.: vasjanaphotography

**Fotografe në Tri-State area (NY, NJ, CT)**

Rezervo setin e shumë dëshiruar fotografik me Vasjanën dhe ktheje imazhin tënd në kopertinë.

**Objektivi që kap shpirtin**



**Krijoni kujtime me sytë e një artisteje**

Nga portreti që zbulon shpirtin, te festat që lënë gjurmë. Vasjana kap bukurinë tënde individuale, ngrohtësinë familjare dhe shkëlqimin e çdo eventit. Fotografi që jeton gjatë, ashtu si ti!